



## **BQK publikon të dhënat e sektorit të jashtëm për tremujorin parë të vitit 2013**

Kumtesë për shtyp  
2 Korrik 2013

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka publikuar statistikën e sektorit të jashtëm, që përfshin: statistikën e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare si dhe statistikën e borxhit të jashtëm të Kosovës, për tremujorin parë të vitit 2013. Të dhënat janë publikuar në kuadër të [Serive Kohore](#) në faqen e internetit të BQK-së, sipas kalendarit të publikimeve t+90 (90 ditë pas periudhës referuese).

Për më shumë, të dhënat e publikuara janë konform standardeve statistikore ndërkombëtare dhe përfshin komponentët standarde siç janë: mallrat, shërbimet, të ardhurat, transferet rrjedhëse (remitancat), investimet e huaja direkte, investimet jashtë vendi në depozita, letrat me vlerë, pozicionin e investimeve ndërkombëtare, asetet dhe detyrimet e jashtme sipas sektorëve, gjendja kumulative e investimeve të huaja direkte sipas shteteve dhe instrumenteve, rezervat ndërkombëtare, borxhin e jashtëm të Kosovës sipas sektorëve, etj.


Këto informata njëherësh janë të shpërndara edhe në FMN-së, në publikimin Statistikat Financiare Ndërkombëtare (anglisht: [International Financial Statistics](#) – IFS) dhe në Bankë Botërore (anglisht: [Quarterly External Debt Statistics](#) – QEDS).

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e përmblodhur që karakterizon tremujorin e parë të vitit 2013 në fushën e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe borxhit të jashtëm. Në fund është paraqitur edhe një shtojcë statistikore lidhur komponentët kryesore.

## Bilanci i pagesave të Kosovës

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në tremujorin e parë të vitit 2013 shënoi vlerën 13.4 milion euro krahasuar me deficitin prej 20.9 milion euro sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit 2012. Kontribuesi kryesor i deficitit mbetet kategoria e mallrave, deficiti i së cilës është rritur për 4.5% dhe ka arritur vlerën 389.7 milion euro në tremujorin e parë të vitit 2013. Në anën tjetër, kontribuesit kryesorë në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë transferet (274.3 milion euro), shërbimet (59.5 milion euro) dhe të ardhurat (42.4 milion euro). Në kuadër të transfereve rrjedhëse, remitancat në tremujorin e parë të vitit 2013 shënuan vlerën prej 127 milion euro, 7% më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2012. Investimet e huaja direkte si një ndër komponentët me peshën më të madhe në kuadër të llogarisë financiare, në tremujorin e parë të vitit 2013 kanë shënuar rritje të lehtë prej 6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën neto prej 60.1 milion euro. Investimeve në letra me vlerë jashtë vendit janë rritur gjithashtu për 53 milion euro dhe kanë ndikuar në rritjen e deficitit në llogarinë financiare.


Figura 1. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, të dhëna jokumulative, në miliona euro



## Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Kosova vazhdon të jetë neto kreditor ndaj pjesës tjetër të botës. Krahasuar me tremujorin paraprak, asetet e jashtme janë rritur për 3.8% duke arritur vlerën 3.85 miliardë euro, kurse detyrimet janë zvogëluar për 0.4% dhe kanë shënuar vlerën 3.44 miliardë euro. Rritjes së aseteve të huaja më së shumti i ka kontribuar rritja e investimeve jashtë vendit në letra me vlerë, ndërsa zvogëlimit të detyrimeve më së shumti i ka kontribuar shlyerja e kredive tregtare. Investimet e huaja direkte kanë ndikuar në rritjen e detyrimeve. Kosova vazhdon të regjistroj bilanc neto pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare, i cili në fund të tremujorit të parë të vitit 2013 ishte 405.9 milion euro.


Figura 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, të dhëna kumulative, në miliardë euro



### Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshinë borxhin privat dhe borxhin publik, në tremujorin e parë të vitit 2013 arriti vlerën 1.45 miliardë euro, 10% më i lartë se sa në tremujorin e parë të vitit 2012. Borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto (398 milionë euro apo 27 % e borxhit të jashtëm bruto). Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i qeverisë i cili në tremujorin e parë të vitit 2013 arriti në 332.8 milionë euro. Rritja e borxhit qeveritar kryesisht i atribuohet kredisë nga FMN-ja në kuadër të programit Stand-By që Kosova ka me FMN-në.

Figura 3. Borxhi i jashtëm bruto, të dhëna kumulative, në miliardë euro



*Shënim: Në kuadër të borxhit publik është përfshirë edhe alokimi i SDR-ve nga FMN-ja*

Borxhi privat, i cili në fund të tremujorit të parë të vitit 2013 shënoi vlerën prej 1.05 miliardë euro, përbën 73% të borxhit të jashtëm bruto të Kosovës. Pjesa më e madhe e borxhit privat është në formë të kredive ndërmjet kompanive që janë në relacion të investimeve të huaja direkte (597 milion euro) e pasuar nga huamarrjet e bankave komerciale (182 milion euro). Sektorët e tjerë të ekonomisë (institucionet financiare jobankare, korporatat jofinanciare, organizatat joqeveritare dhe ekonomitë familjare), në fund të tremujorit të parë të vitit 2013 kanë pasur një borxh bruto prej 274 milion euro. Në këto kategori dominojnë kreditë tregtare të kompanive kosovare importuese të mallrave.

*Shtojca statistikore*

**Tabela 1. Bilanci i pagesave**

(Të dhëna jokumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	T1 2012	T2 2012	T3 2012	T4 2012	T1 2013
<b>Llogaria rrjedhëse</b>	<b>-515.7</b>	<b>-658.4</b>	<b>-380.2</b>	<b>-20.9</b>	<b>-120.9</b>	<b>-143.5</b>	<b>-94.9</b>	<b>-13.4</b>
Mallrat	-1,752.1	-2,059.0	-2,072.8	-372.9	-548.8	-612.0	-539.1	-389.7
Eksporti (f.o.b.)	305.0	324.9	286.9	61.5	78.9	72.0	74.6	71.2
Importi (f.o.b.)	-2,057.1	-2,383.9	-2,359.7	-434.4	-627.7	-683.9	-613.7	-460.9
Shërbimet	186.9	265.7	346.2	47.4	81.4	129.2	88.0	59.5
Eksporti	572.9	618.4	635.0	106.5	146.9	227.3	154.2	104.5
Importi	-386.0	-352.7	-288.8	-59.1	-65.5	-98.0	-66.1	-45.0
Të ardhurat	67.0	113.7	154.1	37.4	44.3	20.3	51.9	42.4
Kredi	176.8	241.2	230.5	59.3	58.3	56.3	56.4	57.2
Debi	-109.8	-127.4	-76.4	-21.9	-13.9	-36.0	-4.4	-14.8
Transferat rrjedhëse	982.4	1021.0	1192.3	267.2	302.1	318.8	304.1	274.3
Kredi	1087.4	1133.5	1296.4	293.5	328.1	345.2	329.4	294.3
Debi	-104.9	-112.4	-104.0	-26.3	-26.0	-26.3	-25.3	-20.0
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>21.3</b>	<b>42.0</b>	<b>12.9</b>	<b>-0.8</b>	<b>2.4</b>	<b>-1.6</b>	<b>13.0</b>	<b>9.6</b>
Kredit	35.7	57.6	31.6	2.7	7.1	2.8	18.8	10.0
Debit	-14.4	-15.6	-18.6	-3.6	-4.6	-4.5	-5.7	-0.4
<b>Llogaria financiare</b>	<b>275.8</b>	<b>377.5</b>	<b>130.3</b>	<b>13.7</b>	<b>75.8</b>	<b>-26.0</b>	<b>66.7</b>	<b>-8.3</b>
Investimet e huaja direkte	331.1	378.9	213.2	54.9	23.4	88.5	46.2	57.0
Jashtë vendit	-34.7	-15.6	-15.7	-1.7	-6.3	-3.7	-3.9	-3.0
Në Kosovë	365.8	394.5	229.0	56.3	29.8	92.2	50.2	60.1
Investimet në letrat me vlerë	-49.2	-56.9	-184.9	-80.7	37.0	-163.2	22.0	-53.4
Asetet	-48.5	-57.7	-185.6	-80.9	37.0	-163.2	21.5	-53.5
Detyrimet	-0.7	0.8	0.7	0.2	0	0	0.5	0
Investimet e tjera	47.3	-5.6	369.2	47.5	32.1	254.8	34.5	-18.3
Asetet	-266.2	-81.6	146.3	112.7	-27.4	107.7	-46.6	39.7
Detyrimet	313.5	76.0	222.8	-65.1	59.6	147.1	81.2	-58.0
Asetet rezervë	-53.3	61.2	-267.2	-8.0	-16.8	-206.1	-36.2	6.3
Gabimet dhe harresat	217.5	239.5	236.8	7.9	42.5	171.2	15.1	11.2

**Tabela 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare**

(Të dhëna kumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012				2013
			T1	T2	T3	T4	T1
<b>PLN Neto</b>	<b>428.8</b>	<b>133.9</b>	<b>230.4</b>	<b>173.1</b>	<b>236.6</b>	<b>248.8</b>	<b>405.9</b>
<b>Asetet</b>	<b>3,246.7</b>	<b>3,325.1</b>	<b>3,344.0</b>	<b>3,352.7</b>	<b>3,634.0</b>	<b>3,705.1</b>	<b>3,847.4</b>
Investimet direkte jashtë vendit	86.4	102.0	103.8	110.2	113.9	117.8	120.9
Investimet në portofolio	693.8	740.2	860.6	814.5	998.7	986.6	1,073.1
Letrat me vlerë të kapitalit	194.2	296.0	348.4	397.7	324.7	354.1	396.6
Letrat me vlerë të borxhit	499.6	444.3	512.3	416.8	674.0	632.5	676.5
Derivatët financiarë	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	1,832.0	1,908.2	1,798.8	1,827.1	1,715.6	1,760.6	1,820.0
Kreditë tregtare	5.7	1.0	1.0	1.0	1.0	1.2	1.2
Kreditë	29.0	52.1	59.0	58.2	79.1	81.3	94.4
Paraja e gatshme dhe depozitat	1,797.3	1,855.0	1,734.7	1,763.1	1,633.3	1,673.9	1,721.3
Asetet tjera	-	-	4.1	4.9	2.1	4.3	3.1
Asetet rezervë	634.5	574.7	580.9	600.9	805.8	840.0	833.4
<b>Detyrimet</b>	<b>2,817.8</b>	<b>3,191.2</b>	<b>3,113.6</b>	<b>3,179.6</b>	<b>3,397.3</b>	<b>3,456.3</b>	<b>3,441.4</b>
Investimet direkte në Kosovë	1,960.8	2,326.1	2,368.3	2,385.3	2,472.5	2,524.3	2,582.2
Investimet portofolio	1.3	2.1	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8
Letrat me vlerë të kapitalit	1.3	2.1	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-
Derivatët financiarë	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	855.7	863.0	744.1	793.7	924.1	931.4	857.4
Kreditë tregtare	144.2	178.2	115.8	167.3	219.6	199.8	120.7
Kreditë	540.4	512.5	475.6	472.8	515.5	541.3	537.4
Paraja e gatëshme dhe depozitat	106.9	105.5	85.1	82.1	115.4	120.9	130.6
Detyrimet tjera	64.2	66.8	67.6	71.5	73.5	69.5	68.8

**Tabela 3. Borxhi i jashtëm**

(Të dhëna kumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012				2013
			T1	T2	T3	T4	T1
<b>Borxhi publik dhe borxhi publik i garantuar</b>	<b>325.9</b>	<b>320.0</b>	<b>312.7</b>	<b>321.1</b>	<b>361.2</b>	<b>401.4</b>	<b>397.9</b>
Qeveria	260	253.6	247.4	253.6	294.2	336.5	332.8
Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-
Afatgjatë	260	253.6	247.4	253.6	294.2	336.5	332.8
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	65.9	66.4	65.3	67.5	66.9	65	65.1
Afatshkurtër	1.7	0.7	1.1	0.7	0.9	0.4	0.3
Afatgjatë	64.2	65.7	64.2	66.7	66	64.6	64.8
<b>Borxhi i sektorit privat</b>	<b>1,022.4</b>	<b>1,106.70</b>	<b>1020.2</b>	<b>1064.1</b>	<b>1175.8</b>	<b>1116.2</b>	<b>1052.2</b>
Bankat	222.3	196.4	162.1	151	184.1	175.6	181.8
Afatshkurtër	222.3	195.2	162.1	151	184.1	175.6	181.8
Afatgjatë	-	1.1	-	-	-	-	-
Sektorët tjerë	294.4	345	277.2	321.8	378.9	350.9	273.7
Afatshkurtër	232.7	259.8	191.3	240	340.6	371.5	239.6
Afatgjatë	61.8	85.1	85.9	81.8	38.3	33.5	34.2
Investimet direkte: kreditimi ndërmjet kompanive	505.7	565.4	581	591.3	612.3	589.7	596.7
<b>Gjithsej (borxhi i jashtëm bruto)</b>	<b>1,348.3</b>	<b>1,426.8</b>	<b>1332.9</b>	<b>1385.1</b>	<b>1536.9</b>	<b>1517.6</b>	<b>1450.1</b>